



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës  
Mbledhja nr. 31

Prishtinë, më 29.1.2019, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Fatmir Xhelili, Xhelal Sveçla, Ismet Beqiri, Fadil Beka, Aida Dërguti, anëtarë.

**Munguan:** Ramiz Kelmendi, Zoran Mojsilović, Daut Haradinaj, Bahrim Shabani.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Dhurata Kryeziu, OSBE; Brikenda Mazrekaj, KDI; Emirjeta Vllahiu, KALLXO.com

**Nga stafi mbështetës i komisionit:** Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

**Mbledhjen e kryesoi,** Haxhi Shala, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 26.11.2018 dhe 3.12.2018;
3. Shqyrtimi i planit të punës së komisionit për vitin 2019;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-015 për letërnjoftim;
5. Të ndryshme.

*Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.*

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

### **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 26.11.2018 dhe 3.12.2018.**

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2019**

**Kryetari** theksoi se draft-plani është përgatitur sipas strategjisë legjislative për këtë vit. Nëse keni propozime shtesë, ju lutem të shtoni.

**Rexhep Selimi**, për planin e punës, sugjeroi që të bëhen disa plotësime dhe kërkoi që të futet edhe Projektligji për komisionarin për Forcën e Sigurisë, pasi projektligji është hartuar në legjislaturën e katërt, me ndihmën e ish-komisionarit gjerman Reinhold Robbe, pasi tashmë kanë kaluar projektligjet për transformimin e FSK-së. Ndërsa, sa i përket përfundimit të punës së grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit të IPK-së, theksoi se mund të bëhet në fillim të muajit shkurt.

**Fatmir Xhelili**, e konsideroi si të nevojshëm shqyrtimin e Projektligjit për komisionarin për FSK-në, por fillimisht kërkoi që të bëhet kërkesë te Ministria e Financave, për të bërë analizën buxhetore, në mënyrë që mos të ketë pengesë në zbatimin e këtij ligji, kur të miratohet.

**Xhelal Sveçla**, duke iu referuar planit të punës, theksoi se shqyrtimi i këtij projektligji është paraparë në muajin maj, por që mund të zhvendoset në muajin shkurt, ndërsa sa i përket buxhetit, theksoi se mund të bëhet përgjatë rishikimit të buxhetit. Sa i përket vizitave në terren, propozoi që në muajin shkurt të realizohet një vizitë në pikat kufitare. Gjithashtu, propozoi që të bëhet edhe një vizitë në komisionin homolog të Shqipërisë, ndërsa sa i përket Projektligjit për pensionimin e pjesëtarëve të policisë, theksoi se në muajin korrik është vonë. Pra, edhe nëse janë planifikuar mjetet, komisioni duhet të kryejë punën e tij, po ashtu edhe Projektligji për sigurinë kibernetike, theksoi se është planifikuar vonë, në fund të vitit.

**Fatmir Xhelili**, lidhur me planin e punës, kërkoi që të hyjë në plan edhe mbikëqyrja e Ligjit të Policisë së Kosovës.

**Rexhep Selimi**, theksoi se pajtohet me qëndrimin e kryetarit, që agjenda e Qeverisë nuk mund të ndryshohet, por shtoi se Projektligji për pensionimin e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës duhet të procedohet më herët dhe jo në muajin korrik, siç është paraparë, pasi edhe në vitet e kaluara

vetëm është shtyrë. Ndërsa, sa i përket Projektligjit për komisionarin, propozoi që të fillohet sa më shpejt, duke qenë se është nismë e komisionit.

**Kryetari** propozoi që në muajin shkurt të vendoset shqyrtimi i Projektligjit për komisionarin.

*Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës, me vota unanime, nxori këtë:*

#### **VENDIM**

*Të fillojë nisma legislative për komisionarin për Forcën e Sigurisë së Kosovës.*

**Kryetari** hodhi në votim edhe planin e punës për vitin 2019.

*Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës, me vota unanime, nxori këtë:*

#### **VENDIM**

*Miratohet plani i punës së Komisionit për vitin 2019, me propozimet e dhëna nga anëtarët e komisionit. Plani, si i tillë, mund të plotësohet në vijim, sipas nevojës.*

#### **4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-015 për letërnjoftim**

**Kryetari** njoftoi se ky projektligj është proceduar nga Qeveria, në muajin dhjetor. Fjalën ua dha anëtarëve të komisionit dhe propozoi formimin e grupit punues për shqyrtimin e këtij projektligji.

*Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës, me vota unanime, nxori këtë:*

#### **REKOMANDIM**

*Komisioni vlerësoi që Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-015 për letërnjoftim, i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit, për t'u proceduar për shqyrtim të parë dhe i rekomandon Kuvendit miratim e tij, në parim.*

**Kryetari** propozoi formimin e grupit punues për shqyrtimin e këtij projektligji.

*Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës, me vota unanime, nxori këtë:*

## VENDIM

*Formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-015 për letërnjoftim. Grupi punues ka këtë përbërje: Fatmir Xhelili, kryesueses, Rexhep Selimi, Ismet Beqiri, Aida Dërguti, Daut Haradinaj, Bahrim Shabani, anëtarë. Secili anëtar i komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjitet grupit punues gjatë punës së tij.*

### 5. Të ndryshme

**Kryetari** njoftoi për kërkesën e marrë nga Inspektorati Policor i Kosovës, që ka të bëjë me pozicionimin e Inspektoratit Policor të Kosovës në projektligjin për zyrtarët publikë dhe Projektligjin për paga. Kërkesa e tyre është për një sistemim meritior, gjë që edhe unë jam dakord.

**Fatmir Xhelili**, theksoi se përfaqësuesit e IPK-së, kanë pasur takim me Komisionin për Administratë Publike, lidhur me kërkesën e tyre, por që ka hasur në rezistencë për plotësimin e kërkesave të tyre tek anëtarët e komisionit, por kategoria që mund të dëmtohet më shumë janë hetuesit, në kuadër të IPK-së. Për këtë arsye, propozoi që insistimi nga komisioni duhet të jetë që hetuesit të kenë pagat, sikurse zyrtarët policorë, që merren me hetime.

**Xhelal Sveçla**, theksoi se kërkesa e IPK-së është e arsyeshme dhe komisioni duhet të mbështesë këtë, pasi ka pasur tendencë të hiqet edhe rrezikshmëria në punë, gjë që nuk është në rregull, pasi puna që bëjnë pozicionet e caktuara në IPK, duhet të kenë trajtim të merituar.

**Kryetari**, po ashtu, theksoi se është nevojshme për miratimin sa më shpejt të Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

**Xhelal Sveçla**, shtoi se pasi janë miratuar ligjet për ndryshimin e misionit të FSK-së dhe propozoi që të bëhet kërkesë nga komisioni, për ndryshimin edhe të emrit të komisionit, duke qenë se tashmë e kemi Ministrinë e Mbrojtjes.

**Rexhep Selimi**, shtroi çështjen e identifikimit të ligjeve, që preken nga ndryshimi i ligjeve për FSK-në dhe Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes. Për këtë arsye, kërkoi që edhe kjo punë duhet të bëhet nga komisioni.

**Kryetari**, me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi takimin e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

---

**Haxhi Shala**

